




# Kanceri i mitrës

## Karcinoma endometriale



### Mitra

Mitra (uterusi) është një organ i zgavërt në formë darthe i vendosur në legenin e femrës, në të cilin fëmija i palindur rritet deri sa të lindet. Mitra përbëhet nga dy segmente/pjesë: trupi muskular i mitrës (corpus uteri) i cili nga brenda është i veshur me një mukozë speciale, dhe qafa e mitrës (cervix uteri) bashkë me gojëzën, që arrin gjer në vagjinë.

Brenda mitrës tumorët mund të zhvillohen në vende të ndryshme:

- > Kanceri i mitrës zë fill në shtresën mukozale e cila vesh nga brenda trupin e mitrës (endometrium).
- > Kanceri i qafës së mitrës zhvillohet nga qelizat e qafës së mitrës.

Ndonëse të dyja llojet e kancerit kanë të bëjnë me të njëjtin organ, ata dallohen shumë nga njëri-tjetri, duke qenë se burojnë nga inde të ndryshme. Për pasojë, këtu do të bëhet fjalë vetëm për kancerin e mitrës.

### Incidenca

Në Zvicër brenda një viti sëmuren rreth 900 femra nga kanceri i mitrës, bëhet fjalë për pothuajse 6 për qind të të gjitha sëmundjeve kanceroze që godasin femrat. Kjo

sëmundje shfaqet rrallë tek femrat më të reja. Mirëpo rreziku nga sëmundja shtohet pas moshës 50-vjeçare: 50 për qind e pacienteve janë midis 50 dhe 70, ndërsa 45 për qind mbi 70 vjeç.

### Simptomat

Kanceri në trupin e mitrës në stadin e tij të hershëm nuk shfaq ndonjë shqetësim. Shenjat e para janë gjakrrjedhjet e pazakonshme, ose urinimi me erë të keqe nga vagjina. Çdo gjakrrjedhje nga vagjina, e shfaqur pas menopauzës, duhet sqaruar nga mjekja (gjinekologjia). Në rastin e femrave para menopauzës, gjakrrjedhjet midis menstruacioneve (periodave) ose gjakrrjedhjet intensive të parëndomta gjatë menstruacioneve, mund të jenë indikacione për një sëmundje kanceroze.

### Diagnoza dhe ekzaminimet

Për të sqaruar dyshimin për prani të kancerit në mitër, mjekja do të realizojë fillimisht një ekzaminim gjinekologjik, me ç'rast do të shqyrtojë me të prekur edhe mitrën. Përmes ultratingullit mund të fitohen imazhe të mitrës dhe të organeve tjera në abdomen; me këtë rast në vagjinën e femrës do të futet një sondë-ultratingull (ultratingulli transvaginal).

Në vazhdim do të pasojë një imazh vizual i mitrës (hysteroskopia). Gjatë këtij ekzaminimi një sondë që nga vagjina do të shtyhet përpara deri në zgavrën e mitrës me qëllim vëzhgimi të brendësisë së mitrës. Me këtë rast nga mukoza e mitrës mjekja do të marrë dhe inde për provë, të cilat do të ekzaminohen më pas në laborator.

Për të konstatuar se sa është përhapur tashmë tumori në organizëm, sipas rrethanash, do të zbatohen dhe ekzaminime të tjera, për shembull një tomografi kompjuterike ose tomografi e rezonancës magnetike, një imazh i fshikës ose një imazh i zorrës së trashë.

### Stadet e sëmundjes

Kanceri i mitrës ndahet në stade të ndryshme. Për këtë qëllim përdoret klasifikimi ndërkombëtar FIGO: FIGO është shkurtësë për Shoqatën ndërkombëtare për gji-nekologë dhe ndihmë gjatë lindjes. Kjo organizatë ka përpunuar një sistem përmes të cilit mund të klasifikohen tumorët në organet gjenitale të femrës.

Kanceri në mitër sipas klasifikimit të FIGO-s ndahet si më poshtë:

- I Tumori është i kufizuar në trupin e mitrës
- II Tumori është përhapur në qafën e mitrës
- III Tumori është përhapur jashtë mitrës, mirëpo akoma është i kufizuar në abdomen
- IV Tumori ka infiltruar fshikën e urinës ose fundin e zorrës së trashë, ose ka formuar metastaza në organe të tjera, për shembull në mëlçi

### Terapia

Se cilat metoda trajtimi do të vihen në veprim varet në mes tjerash se sa ka avancuar tashmë tumori. Kanceri i mitrës pothuajse gjithmonë operohet. Me këtë rast do të hiqen tërësisht mitra, vezëpërçuesit (tubat e Fallopit) dhe vezoret.

Varësisht nga përhapja e tumorit, pas operacionit vjen një terapi rrezatimi (radioterapia). Me këtë rast ekzistojnë dy mundësi rrezatimi:

- > Rrezatimi nga jashtë (radioterapia perkutane/sipërlëkurore): abdomeni rrezatohet nga jashtë me qëllim eliminimi të qelizave kanceroze, të cilat eventualisht mund të jenë akoma të pranishme pas operacionit.
- > Rrezatimi nga brenda (Brachytherapie): Burimet e rrezatimit do të plasohen direkt në segmentin e fundit të vagjinës, me qëllim eliminimi të qelizave të mundshme kanceroze, të cilat eventualisht mund të jenë të pranishme aty ose në indet përreth.

Vetëm kur një operacion duket i pamundur, p.sh. për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore të femrës së prekur, kanceri i mitrës do të rrezatohet pa një operacion paraprak.

Në stade të përparuara, kur tumori tashmë ka krijuar metastaza, vijnë në shprehje mundësi të tjera trajtimi: një kimioterapi ose një marrje medikamentesh që frenon ndikimin e hormoneve seksuale femërore.

### Pasojat e trajtimit

Duke qenë se gjatë operacionit hiqen organet e brendshme seksuale, pas ndërhyrjes femrat e prekura nuk do të mund të mbeten më me barrë. Femrat para menopauzës, pas operacionit do të bien në gjendje klimaksi, duke qenë se mungojnë hormonet seksuale femërore, të cilat normalisht prodhohen në vezore. Për pasojë, do të shfaqen shqetësime tipike klimakterike, si p.sh. zagushia, mukoza e tharë, indisponimet depressive ose gjumi i çrregullt.

### Paskontrollet

Pas përfundimit të trajtimit të kancerit, pacientet duhet ta vizitojnë rregullisht mjeken e tyre për kontrolle gjatë përkujdesjes shëndetësore të mëpasme. Ajo do të japë rekomandime individuale se cilat kontrolle në cilin hark kohor janë të domosdoshme.

### Faktorët rrezikues

Faktorë të ndryshëm shtojnë rrezikun për kancerin në mitër. Këtu do të hynin:

- > *Mosha*: sa më e moshuar të jetë një femër, aq më i lartë është rreziku për kancerin në mitër.
- > *Predispozita trashëgimore*: rreth 5–10 për qind të të gjitha rasteve të kancerit në mitër shkaktohen nga një predispozitë trashëgimore. Femrat e prekurra kanë ndonjë të afërt të ngushtë (motër, nënë ose bijë) gjithashtu të sëmurë prej këtij kanceri.
- > *Metabolizmi i natyrshëm hormonal*: rreziku për kancer të mitrës është paksa më i lartë tek femrat që kanë pasur menstruacionin e tyre të parë para moshës 12-vjeçare, tek ato që kanë pasur menstruacionin e tyre të fundit pas moshës 55-vjeçare, ose tek ato që s'kanë lindur fare fëmijë.
- > *Një terapi shumëvjeçare hormon-substitucionale* gjatë menopauzës vetëm me estrogjen. Të gjitha medikamentet e sotme përmbajnë një kombinacion prej estrogjeni dhe gestagjeni (përpos tek femrat që s'kanë më mitër); me një terapi të këtillë rreziku për kancer në mitër nuk është më i lartë.
- > *Mbipesha*, para së gjithash pas menopauzës.
- > *Sëmurja e mëhershme nga kanceri i gjirit ose ai i zorrës së trashë*.

### Parandalimi dhe zbulimi i hershëm

Një parandalim ose zbulim i hershëm i kancerit në mitër është i pamundur. Mirëpo femrat mund të kontribuojnë që rrezikimin e tyre ta mbajnë në nivel të ulët, në rast se shmangin mbipeshën. Duhet pasur kujdes në përdorimin e preparateve hormonale dhe duhet këshilluar paraprakisht me mjeken.

## Shënim

Ky informacion mund të shkarkohet nga [www.krebsliga.ch](http://www.krebsliga.ch) → Krebskrankheiten (Sëmundjet kanceroze) edhe në gjuhët gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, portugalisht, serbisht-kroatisht-boshnjakisht dhe turqisht. Mos harroni dhe broshurat tona falas në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht nën [www.krebsliga.ch/broschueren](http://www.krebsliga.ch/broschueren).

## Informacion, Këshillim, Mbështetje

### Krebsliga Aargau

Tel. 062 834 75 75  
[www.krebsliga-aargau.ch](http://www.krebsliga-aargau.ch)

### Krebsliga beider Basel

Tel. 061 319 99 88  
[www.krebsliga-basel.ch](http://www.krebsliga-basel.ch)

### Bernische Krebsliga Ligue bernoise contre le cancer

Tel. 031 313 24 24  
[www.bernischekrebssliga.ch](http://www.bernischekrebssliga.ch)

### Ligue fribourgeoise contre le cancer

**Krebsliga Freiburg**  
tél. 026 426 02 90  
[www.liguecancer-fr.ch](http://www.liguecancer-fr.ch)

### Ligue genevoise contre le cancer

tél. 022 322 13 33  
[www.lgc.ch](http://www.lgc.ch)

### Krebsliga Glarus

Tel. 055 646 32 47  
[www.krebsliga-glarus.ch](http://www.krebsliga-glarus.ch)

### Krebsliga Graubünden

Tel. 081 252 50 90  
[www.krebsliga-gr.ch](http://www.krebsliga-gr.ch)

### Ligue jurassienne contre le cancer

tél. 032 422 20 30  
[www.liguecancer-ju.ch](http://www.liguecancer-ju.ch)

### Ligue neuchâteloise contre le cancer

tél. 032 721 23 25  
[www.liguecancer-ne.ch](http://www.liguecancer-ne.ch)

### Krebsliga Schaffhausen

Tel. 052 741 45 45  
[www.krebsliga-sh.ch](http://www.krebsliga-sh.ch)

### Krebsliga Solothurn

Tel. 032 628 68 10  
[www.krebsliga-so.ch](http://www.krebsliga-so.ch)

### Krebsliga St. Gallen- Appenzell

Tel. 071 242 70 00  
[www.krebsliga-sg.ch](http://www.krebsliga-sg.ch)

### Thurgauische Krebsliga

Tel. 071 626 70 00  
[www.tgkl.ch](http://www.tgkl.ch)

### Lega ticinese contro il cancro

tel. 091 820 64 20  
[www.legacancro-ti.ch](http://www.legacancro-ti.ch)

### Ligue valaisanne contre le cancer

tél. 027 322 99 74  
[www.lvcc.ch](http://www.lvcc.ch)

### Krebsliga Wallis

Tel. 027 922 93 21  
[www.krebsliga-wallis.ch](http://www.krebsliga-wallis.ch)

### Ligue vaudoise contre le cancer

tél. 021 641 15 15  
[www.lvc.ch](http://www.lvc.ch)

### Krebsliga Zentralschweiz

Tel. 041 210 25 50  
[www.krebsliga.info](http://www.krebsliga.info)

### Krebsliga Zug

Tel. 041 720 20 45  
[www.krebsliga-zug.ch](http://www.krebsliga-zug.ch)

### Krebsliga Zürich

Tel. 044 388 55 00  
[www.krebsliga-zh.ch](http://www.krebsliga-zh.ch)

### Krebshilfe Liechtenstein

Tel. 00423 233 18 45  
[www.krebshilfe.li](http://www.krebshilfe.li)

### Krebstelefon / Ligne Info- Cancer / Linea cancro

0800 11 88 11  
Nga e hëna në të premten,  
ora 10–18. Gjermanisht,  
frëngjisht, italisht; falas

### migesplus

Schweizerisches Rotes Kreuz  
3084 Wabern  
Tel. 031 960 75 71  
[www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)  
Informacione për migrante  
dhe migrantë

## Impressum

### Autore

Dr. med. Eva Ebnöter,  
Zollikon

### Përkthimi

Bislim Elshani, migesplus

### Ilustrimet

Daniel Haldemann, Wil SG

### Botues

Krebsliga Schweiz  
Effingerstrasse 40  
Postfach 8219  
3000 Bern  
Telefon 031 389 91 00  
[www.krebsliga.ch](http://www.krebsliga.ch)

© 2010

Krebsliga Schweiz, Bern



Broshura u përpilua në kuadër të programit nacional të Entit federal për shëndetësi Migracioni dhe shëndetësia 2008–2013. [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch) – Informacione shëndetësore në shumë gjuhë.